

VENDIM
Nr. 37, datë 7.7.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 16.2.2023 dhe 7.7.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 15 (Sh) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Arseni” sh.p.k.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale,
Zlatevski Ljubisa

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-464 (111), datë 21.3.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të saj; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të shoqërisë “Arseni” sh.p.k. (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Zlatevski Ljubisa, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 6.11.2008 Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (*sot DPPI*), në përputhje me dispozitat e ligjit të kohës nr. 7819, datë 27.4.1994, “Për pronësinë industriale”, ka regjistruar në emër të shoqërisë Neniko Dooel Ljubisa, me adresë Fazanerija 96 Gostivar, R. Makedonija MK, markën me nr. 11992 regjistrimi kombëtar, për pijen B-52 Energy Drink (B-52), sipas elementeve përkatëse.

2. Në datën 16.6.2010, me kontratën nr. 3076 rep., nr. 2163 kol., shoqëria Neniko Dooel Ljubisa, përfaqësuar nga shtetasi Zlatevski Ljubisa, i ka shitur kërkueses markën, emrin, si dhe të gjitha të drejtat për këtë pije, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vendet e tjera ku ajo është e

pajisur me patentë. Kontrata e shitjes është e regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM).

3. Në datën 14.11.2013 kërkesja i është drejtuar DPPM-së me kërkesë për regjistrimin e transferimit, në favor të saj, të pronësisë për markën ndërkombëtare B-52, me nr. 977607 regjistrimi ndërkombëtar. Në vijim, në datën 10.4.2014, DPPM-ja ka dërguar pranë Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) formularin përkatës për ndryshimin e pronësisë për markën ndërkombëtare me nr. 977607 regjistrimi nga pronari Zlatevski Ljubisa te kërkesja.

4. Me urdhrin nr. 13, datë 15.4.2014 (*urdhri nr. 13/2014*), regjistruar me nr. 19 prot., datë 15.4.2014, DPPM-ja ka urdhëruar revokimin e transferimit (ndryshimit) të pronësisë së markës ndërkombëtare, si dhe lënien e kësaj marke në pronësi të pronarit Zlatevski Ljubisa; njoftimin e WIPO-s për pasqyrimin e këtij ndryshimi; njoftimin e palëve të interesuara për këtë ndryshim. Sipas DPPM-së, transferimi i pronësisë së markës ndërkombëtare nga pronari Zlatevski Ljubisa te kërkesja është bërë gabimisht, bazuar në një kontratë shitjeje me anë të së cilës bëhet transferimi i pronësisë së një marke tjetër tregtare, konkretisht i markës kombëtare me nr. 11992 regjistrimi.

5. Kërkesja i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr. 13/2014, me nr. 19 prot., datë 15.4.2014 të DPPM-së; pezullimin e ekzekutimit të këtij akti administrativ deri në përfundim të gjykimit me një vendim të formës së prerë.

6. Me vendimin nr. 4986, datë 22.9.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paditëses shoqëria “Arseni” sh.p.k. kundër DPPM-së dhe ndërhyrësit dytësor Zlatevski Ljubisa; konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr. 13/2014 të DPPM-së; rrëzimin e kërimit për ekzekutimin e përkohshëm të vendimit. Gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se asnjë organ administrativ nuk mund të revokojë një akt administrativ të nxjerrë prej tij nëse ligji i posaçëm që rregullon veprimtarinë funksionale të tij nuk ia ka njohur shprehimisht këtë të drejtë dhe në revokimin e transferimit të pronësisë së markës ndërkombëtare me nr. 977607 nga Zlatevski Ljubisa te kërkesja, DPPM-ja ka vepruar në kapërcim të kompetencave të njohura me ligj. Po sipas gjykatës, asnjë nga dispozitat e ligjit të posaçëm nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale” (*ligji nr. 9947/2008*), që rregullon veprimtarinë dhe kompetencat e DPPM-së, nuk parashikon mundësinë që ky organ të revokojë aktet e tij, të paligjshme ose jo. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 116/b të Kodit të Procedurës Administrative (KPA), urdhri nr. 13/2014 i DPPM-së është vlerësuar prej saj si absolutisht i pavlefshëm (*shih vendimin nr. 4986, datë 22.9.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, faqet 3 dhe 5, paragrafët e fundit*).

7. Mbi ankimin e DPPM-së dhe të Zlatevski Ljubisës, me vendimin nr. 345, datë 2.2.2017, Gjykata Administrative e Apelit, duke e vlerësuar të drejtë, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 4986, datë 22.9.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me të njëjtin arsyetim (*shih vendimin nr. 345, datë 2.2.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit, faqja 5, paragrafi i parafundit dhe faqja 6*). Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit kanë ushtruar rekurs DPPM-ja, si dhe Zlatevski Ljubisa, në cilësinë e personit të tretë në gjykim.

8. Me vendimin nr. 00-2022-464 (111), datë 21.3.2022, Gjykata e Lartë ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe rrëzimin e padisë, duke vlerësuar se këto të fundit nuk kanë interpretuar dhe zbatuar drejt kërkesat e ligjit material. Sipas gjykatës, shkaqet dhe arsyetimi ligjor i përdorur nga organi publik për rivendosjen e ligjshmërisë nuk lidhen me konceptin e revokimit të një akti administrativ, por me atë të konstatimit dhe rregullimit të pasojave të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm, nul, i cili ka dalë në kundërshtim të hapur dhe flagrant me kriteret për transferimin e pronësisë së markës, të parashikuara nga neni 162/2 i ligjit nr. 9947/2008, ku gjen zbatim neni 123 i KPA-së së vitit 1999 në fuqi në kohën e lindjes së mosmarrëveshjes. Në rastin konkret, nuk bëhet fjalë për pavlefshmëri relative, por për pavlefshmëri absolute, e cila mund të konstatohet nga vetë organi që e ka nxjerrë aktin, në çdo kohë. Shoqëria “Arseni” sh.p.k. nuk ka interes të ligjshëm material në ngritjen e padisë, pasi i

referohet kontratës, datë 16.6.2010, për regjistrimin e markës kombëtare B-52 me nr. 11992 regjistrimi, ndërkohë që akti i revokimit objekt gjykimi ka të bëjë me një tjetër markë të regjistruar në emër të Zlatevski Ljubisës që mban nr. 977607 regjistri, për të cilën ajo nuk disponon një marrëveshje të nënshkruar nga të dyja palët për transferimin e pronësisë, si kusht i parashikuar në nenin 162/2 të ligjit nr. 9947/2008 (*shih vendimin nr. 00-2022-464 (111), datë 21.3.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, faqet 6 dhe 7, paragrafët 26 dhe 28*).

9. Në datën 20.7.2022 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-464 (111), datë 21.3.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

10. Me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar”, emërtimi i DPPM-së është zëvendësuar me DPPI-në. Për rrjedhojë, në tekstin e këtij vendimi, emërtimet e këtij institucioni janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës kur janë kryer veprime prej tij.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. Kërkesja, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

11.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

11.1.1. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve nga vlerësimi i bërë nga organi administrativ dhe gjykatat më të ulëta, duke i dhënë kuptim tjetër natyrës së aktit administrativ që qëndron në thelb të mosmarrëveshjes mes palëve. Duke mbajtur qëndrimin se urdhri i revokimit është akt për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik të kryer nga DPPM-ja, Gjykata e Lartë ka bërë vlerësim të ndryshëm të situatës faktike të mosmarrëveshjes, duke ndryshuar natyrën juridike të aktit dhe referencën ligjore. Vetë DPPM-ja nuk e ka konsideruar aktin e saj si absolutisht të pavlefshëm dhe nga subjektet e interesuara nuk është pretenduar asnjëherë pavlefshmëria absolute, por paligjshmëria e vendimit të revokimit. Po kështu, në vendim, Gjykata e Lartë u referohet disa provave, të cilat nuk rezultojnë të jenë pranuar në të njëjtën mënyrë siç arsyetohet ajo nga gjykatat më të ulëta.

11.1.2. *Së drejtës për t’u dëgjuar*, pasi Gjykata e Lartë e ka gjykuar çështjen në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve, në kundërshtim me nenin 62, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Kjo gjykatë nuk e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve edhe pse ka pranuar se vendimarrja e gjykatave më të ulëta është në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore, duke i mohuar në këtë mënyrë kërkeses të drejtën për të parashtruar pretendimet e saj. Në kushtet kur ka ndryshuar cilësimin juridik të aktit të kundërshtuar nga një akt revokues në absolutisht të pavlefshëm, Gjykata e Lartë duhej të thërriste palët në seancë në mënyrë që të dëgjonte pretendimet e tyre në këtë drejtim.

11.1.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë e ka vënë në pozitë të pabarabartë me organin administrativ dhe në pamundësi të paraqesë argumente e prova për sa i përket vlerësimit si absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ të DPPM-së, pavlefshmëri që nuk është pretenduar as nga vetë organi administrativ, si dhe të shprehej për faktet, provat e vlerësimet ligjore.

11.1.4. *Parimit të sigurisë juridike*, në drejtim të *detyrimit për zbatimin e vendimeve të Gjykatës*. Në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese, sipas së cilës organet administrative nuk kanë të drejtë të bëjnë vlerësim të akteve, sikurse është kontrata e shitjes në rastin konkret, pasi një kompetencë e tillë u përket gjykatave, Gjykata e Lartë i ka njohur DPPM-së të drejtën për të bërë vlerësim të kontratës, çka nuk është në kompetencën e këtij organi. DPPM-ja nuk mund të ndryshojë një të drejtë pronësie në mënyrë të njëanshme.

11.2. *Parimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe e drejta për pronë private*, të garantuara nga nenet 11 dhe 41 të Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pasi marka tregtare përfshihet në të drejtën e pronësisë. Në kushtet kur DPPM-ja ka regjistruar aplikimin e kërkuësës, ajo ka fituar të drejtën e pronësisë. Kjo e drejtë nuk mund të ndryshojë në rrugë administrative, por vetëm gjyqësisht.

12. Subjekti i interesuar, DPPI-ja, ka parashtruar:

12.1. Çështja nuk ka më objekt, pasi gjatë periudhës së shqyrtimit gjyqësor të saj marka në fjalë është shfuqizuar fillimisht nga zyra e origjinës në Maqedoninë e Veriut dhe, për pasojë, edhe nga Byroja Kombëtare e WIPO-s. Marka ndërkombëtare nr. 977607 ka pasur mbrojtje në territorin e Republikës së Shqipërisë për pijen B-52 deri në datën 11.12.2018. Sipas nenit 6, pika 1, të Protokollit të Marrëveshjes së Madridit për Regjistrimin Ndërkombëtar të Markave, të ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8992, datë 30.1.2003 (*Protokolli i Madridit*), regjistrimi i një marke në Byronë Ndërkombëtare është i efektshëm për 10 vjet.

12.2. Vendimi i Gjykatës së Lartë është i drejtë, pasi, ndryshe nga sa pretendohet, procedimi administrativ nuk është iniciuar prej saj, por me kërkesë të kërkuësës. Kjo e fundit ka qenë e përfshirë në një tjetër proces gjyqësor, me të njëjtin objekt e me palë kundërshtare Zvlatovski Ljubisen, për shfuqizimin e markës B-52 me numër kombëtar regjistrimi nr. 11992, ndërsa kërkesa e saj e datës 14.11.2013 ka pasur si objekt transferimin e markës me numër ndërkombëtar nr. 977607 regjistrimi. Në zbatim të nenit 162, pika 2, të KPA-së, kontrata e shitjes e datës 16.6.2010 për transferimin e pronësisë së markës kombëtare nr. 11992 nuk është e vlefshme sipas nenit 162/2 të ligjit nr. 9947/2008 dhe nuk mund të përdoret për transferimin e pronësisë së markës ndërkombëtare nr. 977607 regjistrimi. DPPM-ja nuk i ka hequr pronësinë kërkuësës, por, në mënyrë të gabuar, përmes një kontrate të pavlefshme, i ka njohur asaj pronësinë për markën ndërkombëtare, duke ia hequr atë në mënyrë të padrejtë e të paligjshme pronarit të vërtetë e faktik. Pas konstatimit të këtij gabimi, në përputhje me dispozitat e KPA-së, është vendosur revokimi i transferimit të pronësisë për markën ndërkombëtare. Ky veprim nuk është kryer në kapërcim të kompetencave të DPPM-së.

12.3. Kërkuësës nuk i është cenuar *e drejta e pronës*. Ajo nuk ka pësuar asnjë dëm, pasi bëhet fjalë për të drejtën e pronësisë për një markë ndërkombëtare, të cilën ajo nuk e ka gëzuar.

13. Subjekti i interesuar, Zvlatovski Ljubisa, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim edhe pse është njoftuar rregullisht për gjykimin përmes letërpërcorisë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

14. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar. Po kështu, ajo ka shteruar *mjetet juridike efektive* në dispozicion, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i kundërshtuar përmes ankimit kushtetues individual, ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të

inicuar prej saj. Gjithashtu, në përputhje me përcaktimin e nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa është regjistruar në Gjykatë datën 20.7.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor nga dhënia e vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë, që mban datën 21.3.2022. Për rrjedhojë, kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*.

16. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në disa aspekte, si dhe të parimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike e të së drejtës së pronës private.

17. Subjekti i interesuar, DPPI-ja, ka pretenduar se çështja nuk ka më objekt, pasi gjatë periudhës së shqyrtimit gjyqësor të saj, marka në fjalë është shfuqizuar fillimisht nga zyra e origjinës në Maqedoninë e Veriut dhe, për pasojë, edhe nga Byroja Kombëtare e WIPO-s. Marka ndërkombëtare nr. 977607 ka pasur mbrojtje në territorin e Republikës së Shqipërisë për pijen B-52 deri në datën 11.12.2018. Sipas nenit 6, pika 1, të Protokollit të Madridit, regjistrimi i një marke në Byronë Ndërkombëtare është i efektshëm për 10 vjet.

18. Kërkesja ka prapësuar se ky pretendim i DPPI-së përbën kërkim të ri, të paraqitur për herë të parë në gjykimin kushtetues, i cili nuk i është nënshtruar shqyrtimit nga gjykatat e zakonshme dhe, si i tillë, nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

19. Gjykata vëren se objekt i ankimit kushtetues individual është procesi gjyqësor i zhvilluar në lidhje me vendimin e DPPM-së për revokimin e transferimit të pronësisë për markën ndërkombëtare me nr. 977607, gjatë të cilit kjo markë ka pasur mbrojtje në territorin shqiptar. Duke qenë se objekt i ankimit kushtetues individual është ky proces, Gjykata vlerëson se pretendimet e subjektit të interesuar se kërkesa ka mbetur pa objekt, janë të pabazuara. Në këto kushte, kërkesja legjitimohet edhe *ratione materiae* në kërkesën e saj sipas objektit.

20. Për sa i takon thelbit të kerkimit, kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës për t'u dëgjuar, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, parimit të sigurisë juridike, si dhe cenimin e parimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike e së drejtës së pronës. Gjykata vëren se, në thelb, pretendimet e kërkuësës kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor, në aspekt të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar, si dhe me lirinë e veprimtarisë ekonomike e të drejtën e pronës, të garantuara nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës, për rrjedhojë Gjykata vlerëson të analizojë bazueshmërinë në themel të këtyre pretendimeve.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

21. Kërkesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve nga vlerësimi i bërë nga organi administrativ dhe gjykatat më të ulëta, duke i dhënë kuptim tjetër natyrës së aktit administrativ që qëndron në thelb të mosmarrëveshjes mes palëve. Duke mbajtur qëndrimin se urdhri i revokimit është akt për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik të kryer nga DPPI-ja, Gjykata e Lartë ka bërë vlerësim të ndryshëm të situatës faktike të mosmarrëveshjes, duke ndryshuar natyrën juridike të saj dhe referencën ligjore. Vetë DPPM-ja nuk e ka konsideruar aktin e saj si absolutisht të pavlefshëm dhe nga subjektet e interesuara nuk është pretenduar asnjëherë pavlefshmëria absolute, por paligjshmëria e vendimit të revokimit. Po kështu, në vendim, Gjykata e Lartë u referohet disa provave, të cilat nuk rezultojnë të jenë pranuar në të njëjtën mënyrë siç arsyeton ajo nga gjykatat më të ulëta.

22. Subjekti i interesuar, DPPI-ja, ka prapësuar se vendimi i Gjykatës së Lartë është i drejtë, pasi procedimi administrativ nuk është iniciuar prej saj, por me kërkesë të kërkuësës. Kjo e fundit ka qenë e përfshirë në një tjetër proces gjyqësor, me të njëjtin objekt e me palë kundërshtare Zvlatëski Ljubisën, për shfuqizimin e markës B-52 me numër kombëtar regjistrimi nr. 11992. Kontrata e shitjes për transferimin e pronësisë së markës kombëtare nuk është e vlefshme dhe nuk mund të përdoret për transferimin e pronësisë së markës ndërkombëtare. DPPM-ja nuk i ka hequr pronësinë kërkuësës, por, në mënyrë të gabuar, përmes një kontrate të pavlefshme, i ka njohur pronësinë për markën ndërkombëtare, duke ia hequr atë në mënyrë të padrejtë e të

paligjshme pronarit të vërtetë e faktik. Pas konstatimit të këtij gabimi, në përputhje me dispozitat e KPA-së, është vendosur revokimi i transferimit të pronësisë për markën ndërkombëtare. Ky veprim nuk është kryer në kapërcim të kompetencave të DPPM-së.

23. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një *“gjykatë e caktuar me ligj”*. Në zbatim të këtij parimi, Gjykata ka theksuar se kontrolli që Gjykata e Lartë ushtron ndaj vendimeve të ankimuara të gjykatave më të ulëta duhet të fokusohet vetëm në drejtëm të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së këtyre vendimeve. Një kontroll i tillë konsiston në analizën e plotë të fakteve dhe të rrethanave, të cilat janë pranuar më parë si të vërteta nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, pa i ndryshuar ato (*shih vendimet nr. 3, datë 7.2.2023; nr. 1, datë 19.1.2018; nr. 17, datë 10.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Sipas Gjykatës, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Nxjerrja e konkluzionit për provat, në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta, nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë, e cila nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar ose jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës së faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj (*shih vendimet nr. 15, datë 23.3.2023; nr. 44, datë 19.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se me urdhrin nr. 13/2014, DPPM-ja ka urdhëruar revokimin e transferimit të pronësisë së markës me nr. 977607 regjistrimi ndërkombëtar dhe lënien e kësaj marke në pronësi të pronarit Zlatevski Ljubisa, duke arsyetuar se transferimi fillestar i saj ishte bërë gabimisht dhe se kontrata e shitjes i përkiste transferimit të pronësisë për markën kombëtare me nr. 11992. Kërkuesja ka kundërshtuar gjyqësisht urdhrin e DPPM-së për revokimin e transferimit, duke vlerësuar se është nxjerrë në kapërcim të kompetencave të këtij organi. Me vendimin nr. 4986, datë 22.9.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrin nr. 13/2014, vendimi i cili është vlerësuar i drejtë edhe nga Gjykata Administrative e Apelit. Të dyja gjykatat kanë vlerësuar se DPPM-ja nuk mund të revokonte aktin administrativ të nxjerrë prej saj, pasi ligji i posaçëm që rregullon veprimtarinë funksionale nuk ia ka njohur shprehimisht një të drejtë të tillë. Në përfundim të shqyrtimit të rekurseve të DPPM-së dhe personit të tretë, Zlatevski Ljubisa, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe të Gjykatës Administrative të Apelit, duke vlerësuar se veprimet e DPPM-së nuk lidheshin me konceptin e revokimit, por me konstatimin dhe rregullimin e pasojave të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm, çka mund të bëhet nga organi që e ka nxjerrë aktin në çdo kohë.

26. Nga sa më lart, Gjykata konstaton se gjatë vlerësimit të qëndrimeve të mbajtura nga gjykatat më të ulëta dhe interpretimit që i është bërë legjislacionit në fuqi për zgjidhjen e çështjes prej tyre, Gjykata e Lartë ka marrë në analizë parashikimet ligjore të kohës, konkretisht dispozitat e KPA-së, që rregullonin veprimtarinë e organit publik. Po kështu, Gjykata e Lartë ka analizuar edhe dispozitat e ligjit të posaçëm nr. 9947/2008 për pronësinë industriale, që rregullonte të drejtat, detyrimet dhe interesat e ligjshëm të palëve në proces, me qëllim të përcaktimit, përmes interpretimit të dispozitave ligjore në fuqi, të ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen ligjore të mosmarrëveshjes së krijuar.

27. Gjykata vlerëson se gjatë trajtimit të çështjes nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë bërë vlerësim të ndryshëm të provave të administruara nga gjykata e administrative e shkallës së parë ose gjykata e apelit. Në zgjidhjen e themelit të çështjes ajo është bazuar në të njëjtat fakte dhe prova të vlerësuara nga gjykatat më të ulëta. Kontrata e lidhur mes palëve për shitjen e markës tregtare dhe urdhri nr. 13/2014 i DPPM-së, të marra si prova dhe të vlerësuara nga gjykatat e faktit, janë analizuar nga Gjykata e Lartë në funksion të dhënies së një vendimi të arsyetuar. Nga ana tjetër, interpretimi që Gjykata e Lartë i ka bërë konceptit të padisë, si mjet juridik që inicion procesin civil, parimit të disponibilitetit, interesit të palëve në proces, si dhe dispozitave të KPA-së dhe ligjit nr. 9947/2008, nuk përbën vlerësim të ndryshëm të fakteve dhe provave që qëndrojnë në thelb të mosmarrëveshjes së lindur mes palëve.

28. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuësës për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar.¹

B.2. Për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar

29. Kërkuësja ka pretenduar se Gjykata e Lartë e ka gjykuar çështjen në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve, në kundërshtim me nenin 62, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 49/2012, duke e vënë në pozitë të pabarabartë me organin administrativ dhe në pamundësi të parashtrojë argumentet e saj për sa i përket vlerësimit si absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ, pavlefshmëri e cila nuk është pretenduar as nga vetë organi administrativ, duke mos i dhënë asaj as mundësi të shprehej për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore. Sipas saj, kjo gjykatë nuk ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore me prani të palëve edhe pse ka pranuar se vendimmarrja e gjykatave më të ulëta është në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore, duke i mohuar në këtë mënyrë të drejtën për të parashtruar pretendimet e saj. Në kushtet kur ka ndryshuar cilësimin juridik të aktit të kundërshtuar, nga një akt revokues në absolutisht të pavlefshëm, Gjykata e Lartë duhej të thërriste palët në seancë në mënyrë që të dëgjonte pretendimet e tyre në këtë drejtim.

30. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë së armëve, si aspekt i së drejtës për proces të rregullt ligjor, nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2023; nr. 43, datë 27.12.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Jurisprudenca e Gjykatës ka pranuar si elementë përbërës të procesit të rregullt ligjor edhe të drejtën për t'u dëgjuar. Kjo e drejtë, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklaratimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2023; nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 7, datë 12.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

¹ Votuan për pranimin e këtij pretendimi gjyqtarët Sandër Beci dhe Marjana Semini. Sipas këtyre gjyqtarëve, përcaktimi nga Gjykata e Lartë i natyrës juridike të aktit të kundërshtuar përbën vlerësim të ndryshëm të tij nga gjykatat më të ulëta. Në këtë kuptim, interpretimi që Gjykata e Lartë u ka bërë dispozitave ligjore të KPA-së dhe ligjit nr. 9947/2008 rezulton të jetë arbitrar, në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese dhe në cenim të së drejtës kushtetuese të kërkuësës për gjykimin e çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj.

32. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në gjykimin në shkallë të parë kërkuësja ka kundërshtuar urdhrin nr. 13/2014 të DPPM-së, duke e konsideruar atë në kapërcim të kompetencave të këtij organi, ndërsa DPPM-ja ka pretenduar se urdhri i saj është i rregullt dhe i vlefshëm, i nxjerrë për riparimin e një situate të gabuar. Personi i tretë, Zvlatevski Ljubisa, ka pretenduar pavlefshmërinë e kontratës për transferimin e pronësisë së markës ndërkombëtare dhe se DPPM-ja ka vepruar drejt, duke revokuar urdhrin e mëparshëm të saj. Në përfundim të gjyimit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuëses, duke arsyetuar se ligji i posaçëm nuk i ka njohur të drejtën organit administrativ të revokojë aktin administrativ të nxjerrë prej tij dhe një veprim i tillë është atribut vetëm i gjykatës. Për sa i përket personit të tretë, Zvlatevski Ljubisa, gjykata është shprehur se ai ka të drejtën e aksesit për rivendosjen e interesit që pretendon se i është shkelur, duke parashtruar, argumentuar dhe mbrojtur pretendimet e tij përballë kërkuëses, e cila gëzon, gjithashtu, të njëjtat të drejta, bazuar në parimin e kontradiktoritetit. Vendimi i kësaj gjykate është gjetur i drejtë nga gjykata e apelit, si për sa i përket veprimit të kryer nga DPPM-ja, ashtu edhe në lidhje me interesin e personit të tretë.

33. Në analizë të pretendimeve të parashtruara në rekurs dhe të vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta, gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ndërkohë që ka konstatuar se thelbi i mosmarrëveshjes objekt gjykimi lidhet me pretendimin e kërkuëses se DPPM-ja nuk kishte të drejtë të revokonte në mënyrë të njëanshme urdhrin e saj për transferimin e pronësisë së markës ndërkombëtare, ka vlerësuar se shkaqet dhe arsyetimi i përdorur nga organi publik për rivendosjen e ligjshmërisë nuk lidhen me konceptin e revokimit të një akti administrativ, por me konstatimin e rregullimit të pasojave të një akti absolutisht të pavlefshëm, të dalë në kundërshtim të hapur dhe flagrant me kriteret për transferimin e pronësisë së markës, të parashikuara nga dispozitat e ligjit nr. 9947/2008, ku gjen zbatim edhe KPA-ja e vitit 1999, në fuqi në kohën e lindjes së mosmarrëveshjes. Po sipas kësaj gjykate, në rastin konkret, nuk bëhet fjalë për pavlefshmëri relative, por për pavlefshmëri absolute, e cila mund të konstatohej në çdo kohë nga organi që ka nxjerrë aktin.

34. Nisur nga faktet e mësipërme, Gjykata eidenton se, pavarësisht pretendimeve të palëve ndërgjyqëse gjatë gjyimit të çështjes, gjykatat e faktit kanë analizuar dhe vlerësuar bazueshmërinë në ligj të urdhrit të DPPM-së për revokimin e transferimit të pronësisë në kuadër të rregullimeve ligjore ekzistuese dhe parimeve kushtetuese. Po kështu, Gjykata konstaton se edhe pse pavlefshmëria absolute e aktit të nxjerrë prej këtij organi nuk është marrë në shqyrtim nga gjykatat më të ulëta, ajo është vlerësuar për herë të parë nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit. Në jurisprudencën e saj në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se në rastet kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, në zbatim të nenit 473/a, paragrafi 2, të Kodit të Procedurës Civile-së, përpara shqyrtimit të çështjes duhet të urdhërojë njoftimin e palëve dhe caktimin e një afati për depozitimin e parashtrësive të tyre për këto çështje. Edhe sipas nenit 482/a, pika 1, shkronja “b”, të po këtij kodi, Gjykata e Lartë, nëse e vlerëson të nevojshme për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 40, datë 22.12.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Për sa më lart, në rastin në shqyrtim, në kushtet kur as gjykata e shkallës së parë dhe as gjykata e apelit nuk kanë disponuar në lidhje me pavlefshmërinë absolute të urdhrit nr. 13/2014 të DPPM-së dhe cilësimi juridik si absolutisht i pavlefshëm i këtij akti është trajtuar e analizuar në aspektin ligjor vetëm nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerëson se në zbatim të legjislacionit procedural në fuqi, Gjykata e Lartë kishte detyrimin që, përpara gjyimit të çështjes, të njoftonte palët ndërgjyqëse në proces për paraqitjen e argumenteve të tyre në këtë drejtim, me qëllim që, në garantim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit të palëve në gjykim, t'i dëgjonte ata paraprakisht, qoftë edhe me shkrim.

36. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuases për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar, është i bazuar dhe vendimi i Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet.²

37. Në kushtet kur vendimi gjyqësor i kundërshtuar duhet shfuqizuar, pasi është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor dhe çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, Gjykata çmon të mos shprehet për pretendimin tjetër të kërkuases, që ka të bëjnë me cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të së drejtës për pronë private.

38. Në përfundim, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuases, sipas arsytimit të mësipërm, është i bazuar, ndaj duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 e 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-464 (111), datë 21.3.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
 3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 7.7.2023.

Shpallur më 31.7.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj (kundër)

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Anëtarë kundër: Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Elsa Toska

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuases, shoqërisë “Arseni” sh.p.k., për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 00-2022-464 (111), datë 21.3.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë, jemi kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar në tërësi. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashitrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Shumica ka arsyetuar se, pavarësisht pretendimeve të palëve ndërgjyqëse gjatë gjyqimit të çështjes, pavlefshmëria absolute e urdhrit nr. 13, datë 15.4.2014 (*urdhri nr. 13/2014*) të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM) për revokimin e transferimit të pronësisë dhe cilësimi juridik si absolutisht i pavlefshëm i këtij akti nuk është marrë në shqyrtim nga gjykatat më të ulëta, por ajo është trajtuar e analizuar në aspektin ligjor për herë të parë nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit. Në këto kushte, sipas shumicës, në zbatim të legjislacionit procedural në fuqi, Gjykata e Lartë kishte detyrimin që, përpara gjyqimit të çështjes, të njoftonte palët ndërgjyqëse në proces për paraqitjen e argumenteve të tyre në këtë drejtim, me qëllim që, në garantim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit të palëve në gjykim, t'i dëgjonte

² Votuan për rrëzimin e këtij pretendimi gjyqtarët Holta Zaçaj, Marsida Xhaferllari, Elsa Toska dhe Ilir Toska.

ato paraprakisht, qoftë edhe me shkrim. Për rrjedhojë, sipas shumicës, pretendimi i kërkuësës për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar, është i bazuar dhe vendimi i Gjykatës së Lartë duhej të shfuqizohej (*shih paragrafët 33 - 35 të vendimit*).

3. Në ndryshim nga shumica, çmojmë se kërkuësës nuk i është cenuar parimi i barazisë së armëve i lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar. Në vlerësimin tonë, qëndrimi i shumicës nuk përputhet me rrethanat e çështjes konkrete, ndaj standardi kushtetues i përdorur prej saj nuk është i zbatueshëm. Gjykata e Lartë ka trajtuar në vendimmarrjen e saj dy çështje ligjore: i. konceptin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ – urdhrit nr. 13/2014; ii. dhe interesin e ligjshëm të kërkuësës për ngritjen e padisë. Të dyja këto çështje ligjore nuk kanë qenë të reja për palët, për rrjedhojë Gjykata e Lartë nuk ka pasur detyrimin që t'i njoftonte dhe t'i dëgjonte ato paraprakisht.

4. *Së pari*, nga pikëpamja faktike rezulton se pavlefshmëria absolute e urdhrit nr. 13/2014 të DPPM-së, në ndryshim nga sa arsyeton shumica, nuk ka qenë një çështje ligjore e re, e shqyrtuar për herë të parë nga Gjykata e Lartë, por është debatuar dhe vlerësuar përgjatë të gjithë procesit në të gjitha shkallët e gjykimit. Konkretisht, kjo çështje ka qenë objekti i padisë së kërkuësës, që ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e datës 22.9.2014, ndër të tjera, ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të tij sipas Kodit të Procedurës Administrative (KPA), me arsyetimin se asnjë organ administrativ nuk mund të revokojë një akt administrativ të nxjerrë prej tij nëse ligji i posaçëm që rregullon veprimtarinë funksionale të tij nuk ia ka njohur shprehimisht këtë të drejtë dhe në revokimin e transferimit të pronësisë së markës ndërkombëtare dhe se DPPM-ja ka vepruar në kapërcim të kompetencave të njohura me ligj. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin e datës 2.2.2017 e ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit për pranimin e padisë me të njëjtin arsyetim.

5. Këto vendime janë ndryshuar nga Gjykata e Lartë, e cila, me vendimin objekt kundërshtimi, ka vendosur rrëzimin e padisë, duke vlerësuar se gjykatat më të ulëta kishin interpretuar gabim kërkesat e ligjit material. Sipas Gjykatës së Lartë, shkaqet dhe arsyetimi ligjor i përdorur nga organi publik për rivendosjen e ligjshmërisë nuk lidhen me konceptin e revokimit të një akti administrativ, por me atë të konstatimit dhe rregullimit të pasojave të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm, i cili ka dalë në kundërshtim të hapur dhe flagrant me kriteret ligjore për transferimin e pronësisë së markës. Gjykata e Lartë ka evidentuar se nuk bëhej fjalë për pavlefshmëri relative, por për pavlefshmëri absolute, e cila mund të konstatohet nga vetë organi që e ka nxjerrë aktin, në çdo kohë (*shih paragrafin 23 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

6. Duke iu referuar arsyetimit të vendimit, çmojmë se Gjykata e Lartë, në përputhje me funksionin e saj kushtetues të parashikuar nga neni 141 i Kushtetutës, ka shqyrtuar çështjen lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për pavlefshmërinë absolute të akteve administrative, për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore. Në këtë kontekst, ajo ka shpjeguar të drejtën e organit administrativ për të vlerësuar pavlefshmërinë absolute sipas KPA-së dhe se pavarësisht që akti administrativ – urdhri nr. 13/2014 kishte gabime materiale, në thelb, bëhej fjalë për pavlefshmëri absolute. Në këtë mënyrë, ajo ka interpretuar ligjin duke evidentuar rëndësinë e bazës juridike të aktit administrativ, që përcakton organin kompetent dhe procedurën që ndiqet për nxjerrjen e aktit, duke theksuar se referimi gabim i bazës juridike, nuk e bën atë të pavlefshëm ose të paligjshëm. Për rrjedhojë, për këtë pjesë të arsyetimit të saj, Gjykata e Lartë është brenda funksionit të vetë kushtetues të përcaktuar nga neni 141 i Kushtetutës, që mbështetet edhe në jurisprudencën e qëndrueshme të vetë Gjykatës, e cila ka theksuar vijimësisht se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme dhe se ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë e ligjit, ka për detyrë të kontrollojë

mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 29, datë 26.5.2023; nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 16, datë 16.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. *Së dyti*, Gjykata e Lartë, me anë të vendimit të kundërshtuar, ka vendosur rrëzimin e padisë për shkak se kërkuessit i mungonte interesi i ligjshëm për ngritjen e padisë, pra jo me procedurën që ndiqet për pavlefshmërinë absolute të akteve administrative. Shumica nuk është ndalur tek arsyetimi i Gjykatës së Lartë lidhur me interesin e ligjshëm të kërkuesses për ngritjen e padisë, që ishte shkak i vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, duke e lënë në heshtje këtë fakt. Për pasojë, duhet evidentuar se edhe interesi i ligjshëm nuk ishte një çështje ligjore e re e trajtuar nga Gjykata e Lartë, pasi ishte debatuar në të gjitha shkallët e gjykimit, për rrjedhojë palët ndërgjyqëse, përfshirë dhe kërkuessen, ishin në dijeni të saj. Konkretisht, gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë arsyetuar se interesi i ligjshëm i kërkuesses buronte nga kontrata e shitjes që ajo kishte me subjektin e interesuar Zlatevski Ljubisa. Sipas tyre, nxjerrja e urdhrit nr. 13/2014 prekte në mënyrë të njëanshme të drejtat e tyre të mbrojtura nga ligji për pronësinë industriale, sepse shfuqizonte regjistrimin e kryer bazuar në kontratën e shitjes. Ndërsa, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se kërkuessa nuk ka interes të ligjshëm material në ngritjen e padisë, pasi ajo jo vetëm në përmbajtjen e kërkesë padisë por edhe të pretendimeve dhe kërkesës ankimore të bërë pranë DPPM-së i referohet kontratës për regjistrimin e markës kombëtare përkatëse, ku ndërkohë akti i revokimit objekt gjykimi ka të bëjë me një tjetër markë të regjistruar në emër të Zlatevski Ljubisës dhe mban tjetër numri registri, për të cilën pala paditëse nuk disponon një marrëveshje të nënshkruar nga të dyja palët, për transferimin e pronësisë së kësaj marke, si kusht të parashikuar nga ligji për pronësinë industriale (*shih paragrafin 28 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

8. Për sa më lart, çmojmë se Gjykata e Lartë ka ushtruar funksionin e saj kushtetues në trajtimin e dy çështjeve ligjore, që ishin debatuar dhe analizuar nga gjykatat më të ulëta. Për pasojë, ajo nuk kishte ndonjë detyrim për të kryer njoftimin paraprak të palëve ndërgjyqëse, përfshirë kërkuessen, që ato të parashtronin argumentet e tyre në këtë drejtim sepse garancitë e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit të tyre ishin përmbushur tashmë nga gjykatat më të ulëta.

Për rrjedhojë, ankimi kushtetues individual i paraqitur nga shoqëria “Arseni” sh.p.k. nuk duhej të pranohej nga Gjykata, e cila duhej të vendoste rrëzimin e tij.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Ilir Toska, Marsida Xhaferllari